



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGIJË
BORDI

VENDIM

Nr. 89, Datë 28.04.2022

MBI

KËRKESËN E SHOQËRISË “HEC BISHNICA 1, 2” SH.P.K., PËR ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJES NDËRMJET PALËVE, SHOQËRISË FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË SH.A. DHE SHOQËRISË “HEC BISHNICA 1, 2” SH.P.K.

Në mbështetje të nenit 16 dhe 20, gërma “a” dhe “ë”, nenit 24, pikat 1, 2, 3, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 23, pika 12, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr.96, datë 03.09.2016; Rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 114, datë 08.07.2016 dhe “Kontratës për shit-blerje të energjisë elektrike ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sh.a.) dhe Prodhuesve me Përparësi të Energjisë Elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 101, datë 23.06.2016, të ndryshuar; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.04.2021, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike me nr. 579/5 prot., datë 26.04.2022, “Mbi kërkesën e shoqërisë “Hec Bishnica 1, 2” sh.p.k., për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet shoqërisë Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a. dhe Hec Bishnica 1 dhe 2” sh.p.k.”,

Konstatoi se:

- Me shkresën e datës 21 Janar 2022, protokolluar në ERE me nr. 6/4 prot., datë 21.01.2022 me lëndë “Ndërhyrje për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes palëve”, shoqëria “HEC Bishnica 1,2” sh.p.k., i është drejtuar ERE-s për të zgjidhur me marrëveshje Kontratën nr. 227/17 prot., datë 23 Janar 2020.
- Me urdhrin nr. 32/1, datë 09.03.2022, është ngritur grupi i punës për zgjidhjen dhe trajtimin e mosmarrëveshjes ndërmjet shoqërisë FTL sh.a. dhe shoqërisë “HEC Bishnica 1,2” sh.p.k.
- Shoqëria “HEC Bishnica 1,2” sh.p.k. është licencuar për prodhimin e energjisë elektrike me vendimin e bordit të ERE-s nr. 23, datë 23.10.2010, me licencë nr. PV10K. Kjo licencë është modifikuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 34, datë 21.02.2020 dhe afati i vlefshmërisë së saj shtrihet deri më 23.03.2040.

- Shoqëria Furnizuesi i Tregut të Lirë (FTL) sh.a. me vendimin e bordit të ERE-s nr. 199, datë 03.09.2018, është licencuar në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike me licencën nr. F18 dhe afati i vlefshmërisë së saj është deri më 30.09.2023. Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 244, datë 30.03.2016, mbi *“Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”*, i ndryshuar, ka vendosur detyrimin e shërbimit publik për blerjen e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë për shoqërinë publike të furnizimit në tregun e lirë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kontratën tip, të miratuar nga ERE. Kontratat ekzistuese që Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a., ka me prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike janë transferuar te furnizuesi i tregut të lirë, bazuar në aktet e brendshme ligjore/administrative ndërmjet shoqërive. Në këto rrethana palët legjitimohen për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve nga ERE sipas përcaktimeve të akteve ligjore në fuqi.
- Në mbështetje të neneve 13 dhe 20, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, nenit 26, pika 1, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s” miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016, me urdhërin nr. 32, datë 09.03.2022, është ngritur grupi i punës për zgjidhjen dhe trajtimin e mosmarrëveshjes ndërmjet shoqërisë “FTL” sh.a., dhe shoqërisë “HEC Bishnica” 1,2 sh.p.k.
- Duke marrë në konsideratë se: palët “Shoqëria HEC Bishnica 1, 2” sh.p.k. dhe Shoqëria “FTL” sh.a. prej muajsh kanë vijuar komunikimet shkresore për këtë mosmarrëveshje, por edhe për faktin se në seancën dëgjimore të realizuar nga ERE më datë 17.03.2022, dhe që është objekt i mosmarrëveshjes lidhet me zbatimin e një prej akteve rregullatore, vijuan të kenë të njëjtat qëndrime për trajtimin e kësaj mosmarrëveshje vlerësojmë të nevojshme pranimin për shqyrtim nga ERE të mosmarrëveshjes ndërmjet dy shoqërive.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s:

Vendosi:

1. Pranimin për shqyrtim nga ERE të kërkesës së paraqitur nga Shoqëria “HEC Bishnica 1, 2” sh.p.k., për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet Shoqërisë “HEC Bishnica 1,2” sh.p.k. dhe Shoqërisë “FTL” sh.a., duke filluar procedurën për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në përputhje me “Rregulloren për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 114, datë 08.07.2016.
2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s,- brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI